



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:280778

Datë: 22.11.2024

Numri i dokumentit: 06495023

**C.nr.651/2023**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË / DEGA NË MALISHEVË**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri, me bashkëpunëtorin profesional Senad Telaku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.H.nga fshati M.-Komuna e Malishevës, i punësuar pranë Qendrës së Kompetencës “K.K.” në Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson Albert Kryeziu, avokat në Malishevë, kundër të paditurës Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur(AAAPARr) me seli në Prishtinë, të përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore në Prishtinë, sipas bazës juridike për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 1,882.32 Euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 22.11.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PËR SHKAK TË PADËGJUESHMËRISË / MOSBINDJES**

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit S.H.nga fshati M.-Komuna e Malishevës dhe **DETYROHET** e paditura Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur(AAAPARr) me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për periudhën kohore prej datës 22.01.2021 deri me datë 06.02.2023 apo për 24 muaj, (për çdo muaj shumën e mbetur prej 78.43 Euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit, të shkallës prej 35% të pagës bazë-459.95 Euro), t’ia paguaj paditësit të lartcekur shumën e përgjithshme prej 1,882.32 Euro (njëmijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy Euro e tridhjetë e dy cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 29.11.2023 (datë e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.
- II. DETYROHET** e paditura Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur(AAAPARr) me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 134.00 Euro, në afat prej 7 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

**A r s y e t i m**

Paditësi S.H.përmes së autorizuarit të tij, në këtë gjykatë me datën 29.11.2023, ka ushtruar padi kundër të paditurës Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur(AAAPARr) me seli në Prishtinë, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës pranë Qendrës së Kompetencës “K.K.” në Malishevë. Ka kërkuar që në emër të kualifikimit, paditësit t’i paguhet diferenca në pagë nga data 22.01.2021 deri me datë 06.02.2023, në shumën prej 1,882.32 Euro, ka kërkuar kamatën ligjore, si dhe shpenzimet procedurale.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi C.nr.2023:280778, të dt. 09.09.2024, të cilin përfaqësuesi ligjor i të paditurës Avokatura Shtetërore-Ministria e Drejtësisë(Agjencia e Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur(AAAPARr) me seli në Prishtinë) së bashku me shkresat e lëndës e ka pranuar me datë 19.09.2024, fakt të cilin gjykata e konfirmoi nga fletëkthesa që gjendet në shkresat e lëndës e datës 16.09.2024.

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t’i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me shkresat e lëndës në këtë çështje juridike kontestimore, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ke gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150, paragrafi 1, pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, se të paditurës i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto prova dhe atë: Kontrata e punës nr.230/3 e datës 02.10.2018, vërtetimin me nr. prot.1728/3 të datës 20.08.2021, diplomën e kualifikimit universitar nr.234, licencën e mësimdhënësit me nr. ... dhe listën e pagave të lëshuar nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 150 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësin e lëshuar nga Agjencia e Arsimit dhe Aftësimi Profesional dhe Arsimit për të Rritur(AAAPARr) (këtu e paditura), paditësi i lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në Qendrën e Kompetencës “K.K.” Malishevë, si mësimdhënës i lëndëve Bazat e elektroteknikës, Elektronika digjitale, Algorime, Elektroteknikë dhe Praktikë Profesionale.

Nga diploma e kualifikimit universitar, vërtetohet fakti se: Paditësi S.H.studimet e nivelit Master i shkencave të inxhinierisë elektrike i ka mbaruar me datë 13 korrik 2020 (diploma nr.234) në Universitetin e Prishtinës ”Hasan Prishtina”-Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Prishtinë dhe ka marrë titullin Master i Shkencave të Inxhinierisë Elektrike. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet fakti se paditësi realizon pagë bazë në lartësi prej 459.95 Euro dhe në emër të kualifikimit me fakultet për çdo muaj paditësit i është paguar shuma nga 82.55 Euro dhe kjo listë e pagave vërtetohet edhe me datën e lindjes që përputhet me diplomën dhe licencën e lartcekur, si dhe me numrin personal. Gjykata konform nenit 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, provave të lartcekura gjykata ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që: *“Nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se: *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I të tij përcaktohet që: *“Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”*. Pasi nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, se i njëjti ka diplomë universitare me titull Master i shkencave të inxhinierisë elektrike, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

Gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor, përkatësisht me Master, pasi është paguar në shumën prej 82.55 Euro për kualifikim (fakt i provuar nga lista e pagave), ndërsa sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë, është dashur të paguhet në shumën prej 160.98 Euro, (35% e pagës bazë 459.95 Euro), me ç'rast i ka mbetur borxh paditësit për çdo muaj në shumën prej 78.43 Euro dhe atë për 24 muaj  $\times 78.43 = 1,882.32$  Euro, konkretisht për periudhën kohore nga data 22.01.2021 e deri më 06.02.2023, përkatësisht 24 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditësit i takon diferenca për çdo muaj nga 78.43 Euro.

Meqenëse nga parashtrësja e padisë u konstatua se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, fakt ky që nuk u kontestua nga ana e të paditurës, dhe përkundër faktit se e paditura e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit sa i përket kompensimit për kualifikim sepse sipas të njëjtës mësimdhënësit paguhet për çdo muaj për kualifikim, gjithashtu edhe për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, andaj gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmerisë/mosbindjes konform nenit 150, par. 1 të LPK-së ku parashihet që: *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi, b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht”*, për çka vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar në tërësi kërkesëpadinë paditësit për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës në bazë të kualifikimit, dhe atë për periudhën nga data 22.01.2021 e deri më 06.02.2023, përkatësisht 24 muaj.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumat përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 29.11.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj paditësit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 dhe 453.2 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, që i referohet shumës prej 104.00 Euro për përpilim padie dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 30.00 Euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore).

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 150 dhe nenin 160, par. 1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni civil**  
**C.nr.651/23, datë 22.11.2024**

**G j y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.